



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 340/1 prot.

Tiranë më 06.3.2020

Lënda: Mendim mbi një projektvendim

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 312/3 Prot., datë 26.02.2020, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin për miratimin në parim të traktatit ndërkombëtar “Mbi shkëmbimin e të dhënave për verifikimin e deklaratave të pasurisë” dhe relacionin përkatës, vërejmë se shkëmbimi i drejtpërdrejtë administrativ i informacionit të deklaratave të pasurive përfshin edhe transferim ndërkombëtar të të dhënave personale të subjekteve deklaruese.

Sa më sipër, nisur nga fakti që traktati është një marrëveshje ndërkombëtare që do të ratifikohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Zyra Komisionerit vlerëson se transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale, në kuadër të këtij instrumenti, bazohet në germen “a” të pikës 2, të nenit 8 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Gjithashtu, sipas nenit 5 dhe 9 të traktatit, palët marrin përsipër garantimin e masave të sigurisë së informacionit, si dhe zbatimin e legjislacionit të brendshëm, përkatës, për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në çdo rast, Zyra e Komisionerit rekomandon që, gjatë zbatimit të dispozitave të traktatit në fjalë, të respektohen parimet, kriteret dhe detyrimet e parashikuara në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Më tej, duke konfirmuar gatishmërinë dhe vullnetin e vazhdueshëm për të mbështetur institucionet e administratës shtetërore në përmbushjen e detyrimeve të tyre në kuadër të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit vlerëson të arsyeshme përfshirjen e saj në procesin e konsultimit në lidhje me instrumente të tilla ndërkombëtare, që në fazën e negociimit të tyre.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

